



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Prijeto / Prieto / Received / Delivered	11.08.2022	viti / god / year	
Organ / Agjencia / Org. / Jednica / Org. / Unit	Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.	Shtimi / Fotokop / Copies	Saxia / Kopimet / Quantity
SRPM/KIK/4661/2022		1/4	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.582/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca – anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.582/2022 të parashtruara nga ankuesja [redacted] me adresë banimi: [redacted]

[redacted] në Komunën e Prizrenit, kundër Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 11.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.582/2022 e datës 29.06.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. OBLIGOHET Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve që t’ia lëshojë ankueses aktin e emërimit për pozitën “Zyrtar për Pensione në Zyrën e Pensioneve në Prizren”.

III. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm që t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore me qëllim të zbatimit të zbatimit të këtij vendimi në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bazë të autorizimit të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 19.07.2019, me datë 24.07.2019 ka shpallur konkursin për pozitën “Zyrtar për Pensione” në kuadër të Zyrës së Pensioneve në Prizren. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është ftuar të marrë



pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit (testin me shkrim dhe me gojë), ndërsa sipas njoftimi i datës 25.09.2019 për rezultatin e përzgjedhjes përfundimtare të kandidatit për procedurën e rekrutimit rezulton të jetë kandidatja e suksesshme.

Të pakënaqur me procedurën e rekrutimit të zhvilluar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për pozitën "Zyrtar për Pensione në Zyrën e Pensioneve në Prizren", në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kanë parashtruar ankesë dy ankues, ankesa e së cilit e regjistruar me numër A.nr.644/2019 dhe ankesa e së cilës është e regjistruar me numër A.nr.654/2019, ndërsa për shkak të fuqisë së pezullimit të prodhimit të pasojave juridike sipas fuqisë ndërlydhur me ankesat e parashtruara në Këshilli, institucioni në fjalë procedurën e rekrutimit nuk e ka përmbyllur deri në përfundimin e rastit në Këshill.

Ankuesja me datë 29.06.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se të njëjtës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është e obliguar t'ia lëshoj aktin e emërimit, pasi që Këshilli përmes vendimit me numër A.nr.269/2022 të datës 15.04.2022 ka vendosur lidhur me procedurën e rekrutimit në të cilën e njëjta sipas njoftimit të datës 25.09.2022 është vlerësuar kandidate e suksesshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.07.2022, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa Këshilli me datë 13.07.2022 i ka pranuar shkresat e lëndës me numër protokoli:4068/2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses e parashtruar 29.06.2022 të parashtruara në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e datë 13.07.2022 me shkresat e lëndës me numër protokoli:4068/2022 dërguar nga MFPT; Konkursin e datës 24.07.2019; Kërkesën e ankueses të datës 01.06.2022 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT-së; Vendimin e Këshillit A.nr.269/2022 të datës 15.04.2022; Njoftimin e datës 25.09.2019 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.07.2020; E-mailin e datës 22.02.2021 dërguar nga Këshilli për ankuesin E-mailin e datës 14.07.2022 dërguar nga Këshilli për zyrtaren e personelit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, kërkesën e datës 14.07.2022 dërguar nga Zyrtarja e Personelit të MFPT-së për Këshillin me korrespondencën e bashkangjitur për kronologjinë e rastit;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 15.04.2022 ka nxjerrë vendimin A.nr.269/2022 me numër protokoli:2166/2022 përmes të cilit e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses të datës 24.10.2019 ndërsa e ka lënë në fuqi Njoftimin e datës 25.09.2019 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas të cilit njoftim rezulton që në procedurën e rekrutimit për pozitën e

punës "Zyrtar për Pensione në Zyrën e Pensioneve në Prizren" të jetë kandidatja e suksesshme

Po ashtu, nga shkresat e lëndës dhe bazës së të dhënave të ankesave me të cilat Këshilli administron në procedura kontestimore-administrative dhe konflikte administrative pranë gjykatave kompetente rezulton se për rastin e ankueses [redacted] A.nr.654/2019 të datës 24.10.2019, Këshilli përmes Vendimit A.nr.269/2022 të datës 15.04.2022 ka vendosur mbi bazën e Aktgjykimit A.nr.2995/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 16.03.2022, pasi që e njëjta për shkak të mos vendimmarrjes nga ana e Këshillit sipas këshillës juridike e ka proceduar tutje lëndën në Gjykatë.

Ndërsa, lidhur me rastin e ankesës së ankuesit [redacted] A.nr.644/2019 të datës 22.10.2019, Këshilli nuk ka mundur të vendosë për të njëjtat arsye sikurse në rastin e lartcekur, dhe i njëjti është udhëzuar përmes njoftimit zyrtar më këshillën juridike se rastin mund ta procedojë tutje në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, po ashtu Këshilli përmes e-mailit të datës 22.02.2021 i ishte drejtuar me kërkesën nëse i njëjti ka hapur konflikt administrativ, mirëpo ankuesi nuk i është përgjigjur kërkesës së Këshillit, sikurse edhe deri më tani Këshilli nuk ka pranuar asnjë shkresë nga Gjykatat respektive, rrjedhimisht lënda e të njëjtit ka mbetur pezull dhe në rrethanat aktuale nuk mund të trajtohet, mirëpo është për tu theksuar fakti se objekti i shqyrtimit edhe tek kjo ankesë është i njëjtë sikurse në rastin e ankesës së ankueses [redacted] rrjedhimit ky objekt i shqyrtimit tani më është i vendosur përmes vendimit të Këshillit A.nr.269/2022 të datës 15.04.2022, të cilin vendim sipas shkresave të lëndës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e ka pranuar me datë 21.04.2022.

Po ashtu është për tu theksuar fakti se Këshilli deri me tani nuk ka pranuar asnjë shkresë nga Gjykata, nëse ankuesja [redacted] ka parashtruar padi kundër Vendimit të Këshillit A.nr.269/2022 të datës 15.04.2022, përmes të cilit ankesa e ankueses e datës 24.10.2019 me numër A.nr.654/2019 është refuzuar, ndërsa është lënë në fuqi Njoftimi i datës 25.09.2019 për kandidaten e suksesshme, rrjedhimisht Vendimi i Këshillit A.nr.269/2022 i datës 15.04.2022 me numër protkoli:2166/2022 është bërë i ekzekutueshëm.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit shkresave zyrtare dhe provave të lëndës që ndërlidhen me procedurën e rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Pensione në Zyrën e Pensioneve në Prizren" të shpallur përmes konkursit të datës 24.07.2022 nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ku sipas njoftimit të datës 25.09.2019 të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore rezulton që ankuesja [redacted] është kandidatja e suksesshme, në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet: "1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave. 2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme" si dhe në mbështetje të nenit 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: "Ky ligj zbatohet në çdo rast kur një organ publik në realizimin e autoritetit publik: 1.1. vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ" konstaton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në pajtim me dispozitat e aplikuara ligjore obligohet t'ia lëshoj ankueses aktin e emërimit për pozitën "Zyrtar për Pensione në Zyrën e Pensioneve në Prizren".

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.582/2022

Flakron GASHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë së Financave, Punës dhe Transfereve, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së